

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Ferit Osmani , anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.ZH., nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188.par.1. nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1897/2016 datë30.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit F.ZH., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1897/2016 datë 30.03.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.1897/2016 datë 30.03.2018 të akuzuarin F.ZH., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188. par.1. nënpar.1.4 të KPRK dhe të njëjtit i është shqiptuar, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2(dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale. I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqsore dhe atë në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00€ dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € si dhe për mbrojtjen e viktimave shumë prej 30 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur i akuzuarit përmes av. P.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën të aprovojë si të bazuar, aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.1106/2018 datë 24.10.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit F.ZH. Av. Pjetër Përgjoka e ushtruar kundër aktgjykimi të shkallës së parë dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

I akuzuari pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, se është i pa qartë dhe në kundërshtim me faktet dhe provat e administruara. Sipas ankesës, gjykata nuk ka dhënë sqarime bindëse lidhur me shkakun dhe fillimin e mosmarrëveshjes, ku sipas mbrojtjes mungojnë shkaqet e plota të motivit për sulmin dhe po ashtu nuk ka sqarime se çka ka ndodhur në rastin konkret, kontributin e secilit pjesëmarrës dhe faktin se a ka pasur sulm nga ana e të dëmtuarit.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në të cilat thirret mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij, aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzohin anulimin e tij. Aktgjykimi i shkallës së parë, pra edhe dispozitivi, është mjaft i qartë dhe pa kundërthënie me vetveten dhe me faktet e cekura në arsyetim. Në arsyetim janë përshkruar në mënyrë të qartë elementet inkriminuese të të akuzuarit që përbëjnë veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, pra mënyra se si i akuzuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, veprime këto që përmbajnë elementet qenësore të veprës penale për të cilat i njëjti me të drejtë është shpallur penalisht përgjegjës dhe i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në këtë drejtim aktgjykimi përmban edhe arsye të qarta dhe është bazuar në fakte dhe prova të mjaftueshme përkitazi me fajësinë e të akuzuarit.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike i akuzuari në ankesë pretendon që në dispozitivin e aktgjykimit mungojnë shprehjet e duhura për përshkrimin e saktë të lëndimeve dhe kohëzgjatjen e dëmtimit. Po ashtu sipas të akuzuarit gjykata i ka falur besim deklaratës së të dëmtuarit pasi që i njëjti sipas gjykatës ka qenë në përputhshmëri me provat e administruara, ku në realitet i dëmtuari në gjykatë ka dhënë një deklaratë jo të vërtetë. I akuzuari po ashtu thekson se është në moshë të shtyer dhe nuk është në natyrën e tij që ta sulmojë fizikisht dhe të shkaktojë lëndime një personi tjetër.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të të akuzuarit, nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Se i akuzuari, ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188.par.1. nënpar.1.4 të KPRK-së, pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në procedurën e provave gjykata e shkallës së parë ka bërë paraqitjen e provave materiale dhe atë raportin mjekësor të spitalit regional në Prizren me nr.5171 të dt. 05.03.2015, mendimin e ekspertit mjekoligjor dr. F.D. të dt. 24.05.2015, në bazë të të cilave ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë e një gjendje të tillë faktike si të drejtë dhe të ligjshme e aprovoj edhe kjo gjykatë. Sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj Gjykate, Prokuroria Themelore lëshon

Urdhëresë për ekspertin e lëmisë përkatëse e në rastin konkret, ekspertit mjeko-ligjor për dhënien e Mendimit lidhur me natyrën, llojin, shkallën, mjetin me të cilin dyshohet se është shkaktuar lëndimi, pasojat e lëndimeve trupore dhe rrethanave tjera relevante të cilat ndikojnë dhe ndihmojnë në ndriçimin e rastit dhe gjykata e shkallës së parë, në këtë rast ka vlerësuar Mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.D., sipas të cilit, “i dëmtuari ka pësuar dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit” duke mos përcaktuar kohën e shërimit të tani të dëmtuarit, i cili fakt nuk shkruhet asnjëherë në ekspertizat mjekësore për këso lloj dëmtimi trupor.

Me ankesë, i akuzuari aktgjykimin e ankimuar e kundërshton edhe sa i përket shkëlqes së ligjit penal duke u bazuar se konstatimet e aktgjykimi janë në kundërshtim me provat të cilat i ka administruar gjykata.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se duke pasur parasysh se gjendja faktike është vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, edhe ligji penal është aplikuar në mënyrë të drejtë kur gjykata e shkallës së parë të akuzuarin F.ZH. e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK.

I akuzuari me ankesë nuk e ka kundërshtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi dënimin, mirëpo kolegji penal i kësaj Gjykate e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar edhe përkitazi me këtë bazë ankimore konform nenit 396 të KPP dhe vlerësoi se Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me dispozitat e nenit 73 të KPRK, duke i vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin se i akuzuari ka pasur sjelljekorrekte pas kryerjes së veprës penale,, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, më parë nuk ka qenë i dënuar, se ka premtuar që në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të lartcekura dhe se në ankesën e të akuzuarit nuk theksohet asnjë rrethanë lehtësuese e cila do të ndikonte në zbutjen e dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit.

Prandaj, duke pas parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Kolegji penal i kësaj Gjykate gjeti se në arsyetimin e vendimit mbi dënimin, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se “dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti” është në kundërshtim me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar si dhe në aktgjykimin burimor (dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2(dy) viteve) dhe të njëjtin e konsideroi si lëshim teknik me rastin e përpilimit të aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1102/18, me 13.11.2018

Bashkëpunëtori profesional,
Jeton Leci

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi
3. Ferit Osmani